

VENDIM
Nr.135, datë 25.10.2007

**PËR NGRITJEN, ÇAKTIMIN E OBJEKTIT, TË PËRBËRJES DHE AFATIT TË
KOMISIONIT HETIMOR PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR NISJEN E
PROCEDURËS SË SHKARKIMIT NGA DETYRA TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**

Në mbështetje të neneve 77 pika 2 dhe 149 pika 2 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr.8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 3 pika 4, 5 pika 2, 8 dhe 9 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 114 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor Parlamentar për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për “Nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm, zotit Theodhori Sollaku”.

II. Komisioni Hetimor Parlamentar ka për objekt dhe detyrë të verifikojë të dhënat, faktet dhe rrethanat për veprime e mosveprime të Prokurorit të Përgjithshëm, të cilat përbëjnë shkak ligjor për shkarkimin e tij nga detyra, në përputhje me nenin 149 pika 2 të Kushtetutës, si dhe me nenin 7 pika 2 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

III. Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë, 6 nga shumica parlamentare dhe 5 nga opozita. Kryetari i Komisionit i takon grupimit nismëtar të deputetëve.

IV. Komisioni përbëhet nga:

1. Ferdinand Xhaferri	Kryetar
2.	Zëvendëskryetar
3. Pal Dajçi	anëtar
4. Ndriçim Babasi	“
5. Luan Skuqi	“
6. Mehmet Hoxha	anëtar
7. Lajla Pernaska	“
8.	“
9.	“
10.	“
11.	“

V. Komisioni do ta zhvillojë veprimtarinë e tij brenda afatit 1-mujor nga data e miratimit të këtij vendimi.

VI. Ngarkohen Kryetarja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm të krijojnë kushtet e nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të këtij Komisioni.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)